



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 13.7, 14.7, lidhur me nenin 16.2 dhe të nenit 19.2 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullores nr. 2003/30, të dt. 10.09.2003, të nenit 3, par.1, pika b, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, të nenit 19, par.1, pika b dhe të nenit 40, par 3, pika II të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 04.05.2006, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES PËR KOMPLEKSIN
E DESTINUAR PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE INDIVIDUALE TË BANIMIT
NË LAGJEN “ ARBËRIA 2 ” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues për kompleksin e destinuar për ndërtime individuale të banimit në lagjen “ Arbëria 2” në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është parcelimi dhe formimi i parcelave ndërtimore, të madhësisë së nevojshme, për ndërtimin e shtëpive familjare, caktimi i kushteve për rregullimin e hapësirës, si dhe caktimi i rregullave të lokacionit të objekteve, i linjave rregulluese, i linjave të ndërtimit, i normave teknike urbanistike dhe i kushteve të tjera lidhur me lokacionin e ndërtesave të kësaj kategorie të objekteve dhe ndërtimeve të tjera në parcelat ndërtimore, të formuara brenda kufijëve të kompleksit, të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, konform destinimeve të parapara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-031-1231/1, të dt. 02.07.2004.

Neni 3

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet kompleksi i cili përfshin parcelat kadastrale nr.4359, 4360, 4361, 4362, 4363, 4364, 4365, 4366, 4367, 4368, 4369, 4370, 4371, 4372, 4373, 4374, 4375, 4382, 4385, 6140, 6141, 6142, 6143, 6144, zona kadastrale - Prishtinë, me një sipërfaqe të përafërt prej 1.50.00 ha.

Neni 4

Bartës i detyrës programore dhe i hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të jetë Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës do të kryejë veprimet e nevojshme nga përgjegjësia e tij e caktuar për hartimin e planit sipas këtij Vendimi.

Drejtoratet tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, janë të obliguara që t'i sigurojnë dhe t'i dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë, të cilat mund të konsiderohen të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Mjetet financiare eventuale plotësuese për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Afati i hartimit të Planit rregullues, nga neni 2 i këtij Vendimi, do të jetë fundi i muajit qershor të vitit 2006.

Neni 7

Miratimi përfundimtar i Planit rregullues të finalizuar sipas këtij Vendimi, do të bëhet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Neni 8

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 9

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01 Nr. 351-212, më 04.05.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri